



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

18559

10.10.2022

UDHËZIM

Nr. 28, Datë 10.10.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.31, DATË 26.12.2013 "PËR EMETIMIN  
NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
TË OBLIGACIONEVE NË FORMË REGJISTRIMI" I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe neneve 5 dhe 20 të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.31, datë 26.12.2013, "Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi", bëhet një ndryshim si më poshtë:

Neni 1

Pika 1 e nenit 9, ndryshohet si vijon :

Shuma minimale e lejuar për pjesëmarrje në ankandet e obligacioneve në Lekë është 300.000.00 (treqind mijë) Lekë, ndërsa shuma minimale për pjesëmarrje në ankandet e obligacioneve në valute është 3.000.00 (tre mijë) Euro/USD.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi pas Botimit ne Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ

